



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT LUMOR ISHËM

VENDIM

Nr. 3, datë 10.02.2026

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR NXJERRJE DHE SHFRYTËZIM TË UJIT
NËNTOKËSOR NËPËRMJET SHPIMIT, PËR QËLLIME TË
NDRYSHME, TË SUBJEKTIT “COCA-COLA BOTTLING SHQIPËRIA”
SH.P.K., ME VENDNDODHJE: AUTOSTRADA TR-DR KM5, KASHAR,
BASHKIA TIRANË.

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 141, të ligjit nr.29/2024, “Për Burimet Ujore”, i ndryshuar, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.319, datë 11.06.2025, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për përdorim burimi ujor, dokumenteve shoqëruese, procedurës së shqyrtimit e vendimmarrjes, formateve të lejes, autorizimit, kushteve të posaçme dhe afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli Basenit Lumor Ishëm,

V E N D O S I:

1. Miratimin e kërkesës për leje për nxjerrje dhe shfrytëzim të ujit nëntokësor nëpërmjet shpimit, për qëllime të ndryshme, të subjektit “Coca-Cola Bottling Shqipëria” sh.p.k., me vendndodhje: Autostrada Tr-Dr km5, Kashar, Bashkia Tiranë.

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujor (Pus-shpimi CC1):

- X= 479368.82
- Y= 4579859.51
- Z= 62 m

- Sasia e ujit që jepet në përdorim : $Q = 5 \text{ l/sek}$
- Qëllimi i përdorimit : Për pije joalkolike, ambalazhim në shishe ose enë.
- Thellësia e pus-shpimit: 40 m
- Thellësia e vendosjes së pompës : 32 m
- Koordinatat e pikës së shkarkimit (KRGJSH)

$X = 479301.80;$

$Y = 4579869.26;$

$Z = 57.55 \text{ m}$

- Prurja që shkarkohet: $Q = 0.5 \text{ l/sek}$

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas njoftimit të përmbajtjes së vendimit subjektivit.

KRYETARI I KBL ISHËM

ADRIAN GURRA

